



Datë: 01.04.2025

Numër Protokolli: 2278/2025

A.nr.231/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, Atdhe Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.231/2025 të datës 28.01.2025, të parashtruar nga ankuesi F.G, kundër organit të punësimit/Organit Shqyrtues të Prokurimit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.231/2025 e datës 28.01.2025, e parashtruar nga ankuesi, F.G.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 81/25 i datës 23.01.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me përfundimin e procedurës së pranimit më numër të referencës RN00016045.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, F.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 28.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 603/2025, të regjistruar nën shenjën A.nr.231/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00016045, për pozitën e klasës së ulët drejtuese “*Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative*”, i shpallur më datë 13.12.2024 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit, ndërsa ky i fundit më datë 18.02.2025, ka përcjellë përgjigjën në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1624/2025 të datës 12.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 603 të datës 28.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00016045, të datës 13.12.2024; Pasqyrën e llogarisë së trustit pensional; CV e ankuesit; Dokument identifikimi; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 18.02.2025; Aplikacionin e ankuesit të datës 03.01.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës; Listën e kandidatëve të refuzuar; Njoftimin me numër protokolli 81/25 të datës 23.01.2025; Njoftimin e datës 22.01.2025; Aplikacionet e kandidatëve pjesëmarrës, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, **sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i provave të lëndës, ka gjetur se Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.12.2024, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016045, për pozitën e klasës së ulët drejtuese “*Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative*”, me afat aplikimi nga data 14.12.2024 deri më datë 12.01.2025.

Si rrjedhojë, si kërkesa të përgjithshme formale për këtë procedurë rekrutimi ishin përcaktuar këto: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në drejtimet: Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, Informatikë Inxhinierike, Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji Informative, Inxhinieri Elektronike Kompjuterike me Telekomunikacion.* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale për pozitën të cilën zhvillohet procedura e pranimit.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej nëntë (9) kandidatë, mirëpo prej tyre asnjë kandidatë nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit përkatës, në mesin e tyre edhe ankuesi, të cilit sipas Njoftimit të datës 22.01.2025, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk i njëjti nuk ka plotësuar kriteret e konkursit, gjegjësisht nuk ka bashkangjitur dëshmitë mbi përvojën e punës.

Rrjedhimisht, Njësia e Burimeve Njerëzore e Organit Shqyrtues të Prokurimit, më datë 23.01.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 81/25, nga i cili njoftim rezulton se procedura e rekrutimit me numër reference RN00016045, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative*, ka përfunduar, pasi që asnjëri nga kandidatët nuk ka kaluar verifikimin paraprak.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kërkon rishqyrtimin vendimit për refuzimin e aplikacionit të tij, në përputhje me dispozitat ligjore dhe procedurat e përcaktuara.

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit si më sipër, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohej se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: *2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion,*; dhe se po ashtu sipas shpalljes së konkursit të datës 13.12.2024 të gjithë kandidatet kanë qenë të njoftuar lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, duke përfshi këtu edhe: *Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmitë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, nga analizimi i aplikacionit të dorëzuar nga ankuesi me datë 03.01.2025, ka gjetur se i njëjti ka plotësuar kriterin arsimor, ngase ka bashkangjitur Diplomën me Nr.100, të lëshuar më datë 26.03.2019, nga Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”, mbi të cilin dokument dëshmohej se i njëjti më datë 05.02.2019 ka mbaruar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, Programi Informatikë Inxhinierike, duke fituar kështu titullin Bachelor i Shkencave në Informatikë Inxhinierike.

Mirëpo, lidhur me plotësimin kriterit të përvojës së punës tri (3) vjeçare për pozitën të cilën zhvillohet procedura e pranimit Kolegji i Këshillit, duke bazuar në dispozitat ligjore të lartë theksuar dhe kërkesat e përcaktuara të konkursit të datës 13.12.2024, dhe në bazë të dokumentacionit të bashkangjitur nga ankuesi, konstaton se i njëjti nuk ka vërtetuar se plotëson këtë kriter të konkursit, ngase sipas dokumenteve të bashkangjitura dëshmon se posedon 1 vit e 4 muaj përvojë pune profesionale, konkretisht ankuesi sipas Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta, dëshmon se nga data 24.08.2021 deri më 23.12.2021 ka qenë i angazhuar në cilësinë e Zyrtarit të Teknologjisë Informative në Komisionin Qendrorë të

Zgjedhjeve (KQZ) si dhe sipas Kontratës së Punës me Nr.30977/23447, ankuesi dëshmon se nga data 01.10.2023 deri më 30.09.2024 ka qenë i angazhuar në cilësinë e Analistit të Sigurisë Kibernetike, pranë Kompanisë Kosovare për Distribuidim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Ndërsa, Kolegji i Këshillit Aneks Kontratën e Punës me Nr.protokolli 591/2023 të datës 23.05.2023, të lëshuar nga “Art Motion”, nuk mund ta marrë për bazë si dëshmi për vërtetimin e përvojën e punës jashtë institucioneve publike, edhe pse faktikisht sipas pasqyrës së llogarisë së trustit pensionale ankuesit i rezultojnë të paguara kontributet pensionale tek ky organ punëdhënës i sektorit privat, mirëpo sipas këtij dokumenti nuk përcaktohet apo specifikohet se cilën pozitë të punës e ka ushtruar ankuesi, thënë më konkretisht sipas saj vetëm theksohet se Kontrata e Punës e lidhur më datë 18.10.2021 është ndryshuar, ashtu që e njëjta hynë në fuqi nga data 01.07.2023 dhe ankuesit ti vazhdohet marrëdhënia e punës nga data 01.07.2023 deri më datë 30.06.2024. Rrjedhimisht, ankuesi as në ankesën e datës 28.01.2025, të parashtruar në Këshill, nuk ka vërtetuar me dëshmi se mund të ndryshoj gjendjen faktike, ngase nuk ka bashkangjitur vërtetim apo kontratë pune tek “Art Motion” që mund të vërtetonte specifikisht pozitën në të cilin ka qenë i angazhuar dhe periudhën saktë kohore të angazhimit.

Andaj, bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më sipër Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara, ngase i njëjti me dokumentacionin e bashkangjitur nuk ka dëshmuar se plotëson kriterin e përvojës së punës tre (3) vjeçare të përcaktuar me konkursin përkatës, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në OSHP, me Njoftimin e datës 22.01.2025, mbi të cilin ankuesit i ka refuzuar aplikacionin dhe Njoftimin për përfundimin e procedurës me numër protokolli 81/25 të datës 23.01.2025, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 44 paragrafi 5 dhe 6, ku përcaktohet se: *5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese.,* ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të këtij Ligji.

Kështu që, thënë si më sipër e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.231/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.G;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.